

Përgatitja për takim tuaj të mbështetjes financiare për fëmijën

Përpara takimit tuaj

Plotësoni dy hapat e mëposhtëm:

- 1** Plotësojeni, nënshkruajeni dhe kthejeni formularin e regjistrimit për marrjen e mbështetjes financiare për fëmijën brenda **10 ditëve** nga marrja e kësaj pakoje. Do të zgjasë rreth 30 minuta. Ka dy mënyra për ta kthyer në kohën e duhur.

Opsioni 1: Më i thjeshti | Shkarkoni aplikacionin celular për mbështetjen financiare për fëmijën, më pas plotësoni dhe dërgoni formularin.



Shkarkoni aplikacionin e HRA-së për mbështetjen financiare për fëmijën në qytetin e Nju-Jorkut (NYC Child Support) falas nga App Store ose Google Play. Nëse dëshironi informacion shtesë rreth veçorive të aplikacionit celular, vizitoni faqen tonë të internetit në nyc.gov/childsupportmobile.



Nëse e dërgoni formularin e regjistrimit nëpërmjet aplikacionit, ju gjithashtu mund të ngarkoni kopje të dokumenteve mbështetëse duke përdorur aplikacionin.

Opsioni 2: Plotësoni formularin e bashkëngjitur të regjistrimit ose shkarkojeni nga faqja e internetit dhe dërgojeni.

Për të shkarkuar një formular, shkoni te <https://on.nyc.gov/custodialparent> dhe kërkoni formularin e regjistrimit për marrjen e mbështetjes financiare për fëmijën ose përdorni kodin QR në të djathtë.



Pasi të plotësoni formularin e regjistrimit, dërgojeni me email, personalisht ose me postë.

1) Dërgojeni formularin me email në dcse.cseweb@dfa.state.ny.us me subjekt "Formular i Regjistrimit për Marrjen e Mbështetjes Financiare për Fëmijën";

2) Silleni formularin e regjistrimit te zyra e shërbimeve të mbështetjes financiare për fëmijën në zonën ku jetoni. Vendndodhjet mund t'i gjeni te <http://bit.ly/CSoffices>; ose

3) Dërgojeni formularin me postë në:
OCSS, PO Box 830
Canal Street Station
New York, NY 10013

Mbani një kopje të formularit të plotësuar dhe të nënshkruar dhe merreni me vete tek intervista.

Kopjet dhe përkthimet e këtij dokumenti dhe të të gjithë dokumenteve të referuara mund t'i gjeni në <https://on.nyc.gov/custodialparent> ose përdorni kodin QR më poshtë.



Përpara takimit tuaj (Vazhdimi)



Përpara se të shkoni te takimi juaj, lexoni “Njoftimin mbi përgjegjësitë dhe të drejtat për mbështetjen financiare LDSS-4279” dhe “Informacionin për të gjithë aplikantët e mundshëm të mbështetjes financiare për fëmijën në lidhje me marrjen e mbështetjes financiare për fëmijën në mënyrë të sigurt W-280a”. Nëse keni shqetësime në lidhje me sigurinë pas leximit të këtyre dokumenteve, kontaktoni punonjësën e FIA-së, i cili do t’ju referojë te një Koordinator i HRA-së për Dhunën në Familje. Së bashku mund të vendosni nëse marrja e mbështetjes financiare për fëmijën është një veprim i sigurt për ju dhe familjen tuaj.

2

Mblidhni dhe dërgoni dokumentet mbështetëse së bashku me formularin e referimit për mbështetjen financiare për fëmijën

Nuk përbën problem nëse nuk i keni të gjitha dokumentet. Dërgoni dokumentet që keni së bashku me aplikimin e plotësuar. Nëse nuk jeni të sigurt ose nëse nuk i keni të gjitha dokumentet e nevojshme, do t’ju njoftojmë gjatë intervistës.

- Formulari i plotësuar i regjistrimit për marrjen e mbështetjes financiare për fëmijën, i nënshkruar;
- Certifikata e lindjes për çdo fëmijë, nëse nuk është dorëzuar më parë pranë Administratës së Burimeve Njerëzore (HRA);
- Një dokument që tregon se kush është babai apo pretendohet të jetë babai, nëse keni
- Certifikata e martesës, dekreti i divorcit ose letrat e ndarjes, sipas rastit;
- Fotografi e kohëve të fundit të prindit;
- Dokumente që tregojnë numrin e sigurimeve shoqërore dhe të ardhurat e prindit tjetër (prindit jokujdestar); **dhe**
- Çdo dokument që mund të ndihmojë OCSS-në të gjejë prindin tjetër.

Sillni çdo informacion tjetër që do të ndihmojë OCSS-në të gjejë prindin tjetër.

- Adresën, numrat e telefonit dhe informacionin e punëdhënësit të prindit tjetër.
- Datëlindjen, vendlindjen dhe emrin e prindërve të prindit tjetër.

Sigurohuni që të përfshini emrin tuaj, datëlindjen tuaj dhe ID-në e çështjes në të gjitha dokumentet e dorëzuara.

Ditën e takimit

- Nëse keni një intervistë ku duhet të jeni personalisht, regjistrohuni te dritarja e pranimit kur të mbërrini. Merrni me vete një kopje të formularit të referimit për mbështetjen financiare për fëmijën që keni dërguar. Gjithashtu, merrni me vete një kopje të të gjitha dokumenteve mbështetëse dhe çdo gjë shtesë që keni gjetur pasi të keni dërguar pakon.
- Nëse keni një takim nga telefoni, jini të disponueshëm për t’iu përgjigjur telefonit. Mund të mos e njihni numrin tonë të thirrjes në telefon.
- Nëse ju duhen shërbime përkthimi, informoni punonjësën e çështjes suaj.
- Mesatarisht, një takim mund të zgjasë rreth 1 orë, në varësi të çështjes suaj.

Pyetje?

Nëse keni pyetje të tjera rreth intervistës për mbështetjen financiare për fëmijën, ose dëshironi të flisni me dikë për çështjen tuaj, vizitoni ose kontaktoni zyrën lokale për zonën tuaj. Gjeni zyrën lokale të zonës suaj në <https://on.nyc.gov/contactocss>.

Kopjet dhe përkthimet e këtij dokumenti dhe të të gjithë dokumenteve të referuara mund t’i gjeni në <https://on.nyc.gov/custodialparent> ose përdorni kodin QR më poshtë.

